LIGJ
Nr. 8292, datë 25.2.1998

PËR FORCAT SPECIALE DHE ATO TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë përbëhen nga njësi të specializuara të policisë, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji për zgjidhjen e situatave, kur ka prishje të rënda të rendit, akte terrorizmi e banditizmi dhe krime të tjera të rënda, detyra të cilat nuk mund të kryhen nga forcat e tjera të policisë.

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë bëjnë pjesë në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Ministrinë e Brendshme.

Neni 2

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë gjatë ushtrimit të detyrës, zbatojnë me përpikëri dispozitat kushtetuese, kërkesat e ligjit dhe respektojnë e mbrojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve.

KREU II
ORGANIZIMI I FORCAVE SPECIALE DHE ATYRE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 3

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë përbëhen nga efektiva oficerë, nënoficerë dhe policë me pagesë. Organika e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Uniforma dhe shenjat e veçanta të reparteve të forcave speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë caktohen nga Këshilli i Ministrave. Ato nuk mund të përdoren nga organet e tjera.

Çdo pjesëtari të njësive të forcave speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë i garantohet fshehtësia e identitetit personal gjatë ndërhyrjes dhe pas saj.

Neni 5

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë janë rezervë e drejtorit të përgjithshëm të policisë dhe drejtohen nga drejtoria e forcave speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë. Veprimtaria e këtyre forcave shtrihet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Aktivizimi i tyre me shërbim për detyra konkrete bëhet me urdhër të veçantë të drejtorit të përgjithshëm të policisë.

Neni 6

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë pajisen me armë, mjete e pajisje speciale për përmbushjen e detyrave të caktuara nga ky ligj.

KREU III
DETYRAT E FORCAVE SPECIALE DHE ATYRE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 7

Forcat speciale:

- kryejnë operacione të shkallës së lartë të vështirësisë për arrestimin e individëve dhe grupeve kriminale në çdo lloj rrethane e objekti;
- kryejnë operacione për shoqërimin e personave shumë të rrezikshëm në gjykata, burgje, institucione riedukimi ose që ekstradohen;
- kryejnë operacione për sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore, kur ata kërcenohen nga një rrezik real dhe serioz;
- kryejnë operacione për shtypjen e revoltave në burgje, dhomat e paraburgimit dhe institucionet e riedukimit;
- kryejnë operacione për shpëtimin e pengjeve;
- mund të kryejnë operacione në ndihmë të popullsisë në rastet e fatkeqësive të rënda natyrore e aksidentale.

Neni 8

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë:

- ndërhyjnë për rivendosjen e rendit të prishur nga veprime e akte të rënda dhune e vandalizmi në qendra të banuara, stadiume, aeroporte, porte, stacione treni e në mjedise të tjera publike, kur kjo detyrë është e pamundur të kryhet nga shërbime të tjera të policisë;
- rrethojnë, detyrojnë të dorëzohen dhe, në pamundësi, asgjësojnë persona ose grupe personash që kanë kryer ose dyshohen se kanë kryer vepra penale të rënda me dashje, të cilët synojnë të largohen duke çarë rrethimin me tentativë, ose përdorin armë zjarri, lëndë plasëse a me mjete të tjera të rrezikshme për jetën. Në raste të veçanta dhe kur disponohen prej tyre mjete të rrezikut në masë, paragrafi i mësipërm të zbatohet edhe ndaj personave të tjerë;
- ndërhyjnë për kapjen e personave të kërkuar, kur ata ndodhen në bazat e tyre dhe nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë gjatë ndërhyrjeve;
- ndihmojnë shërbimet e tjera të policisë për zhvillimin normal të tubimeve publike të miratuara;
- marrin pjesë në bllokimin e elementëve dhe grupeve terroriste, si dhe mbështesin me mënyra të ndryshme veprimet operacionale të forcave që realizojnë kapjen , neutralizimin ose asgjësimin e terroristëve;
- ndërhyjnë për kapjen ose asgjësimin e bandave që grabitin në zona të veçanta, në akset rrugore nacionale, si dhe mbajnë nën kontroll të përhershëm drejtimet e kalimet doganore, kur kërkohet mbështetja nga forcat e tjera të policisë;
- marrin në ruajtje objekte të rëndësishme shtetërore, si porte, aeroporte, PKPK, trena e stacione trenash, burime energjetike, televizionin e radion shtetërore, Muzeun Kombëtar, objekte dhe institucione qendrore e të pushtetit lokal etj., deri në rivendosjen e rendit e të situatës normale, kur këto detyra nuk mund të përballohen nga forcat e ngarkuara për këtë qëllim;
- shoqërojnë persona të rrezikshëm për në vendet e sigurisë së lartë, kur ka të dhëna për ndërhyrje me veprime të armatosura për lirimin e tyre;
- ndërhyjnë për vendosjen e gjendjes normale në burgje dhe në institucionet e riedukimit, kur ka rebelime të të burgosurve, rrezikohet jeta e policëve, shkelen rëndë rregullat e brendshme, tentohet të çahet rrethimi i jashtëm i objektit dhe kur ka përleshje ndërmjet grupeve të të dënuarve;
- mund të ndihmojnë shërbimet e mbrojtjes civile në evakuimin e popullsisë në raste përmbytjesh, zjarresh masive, si dhe shërbimet e tjera të policisë për gjetjen dhe nxjerrjen e viktimave

dhe për furnizimin e popullsisë me ushqime, medikamente e materiale të tjera për jetesë.

KREU IV
TË DREJTAT E FORCAVE SPECIALE DHE TË ATYRE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 9

Forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë kanë këto të drejta:

1. Të hyjnë në zyrat shtetërore, me përjashtim të objekteve që ruhen nga Garda , në ato private ose të organizatave, në mjediset e tyre dhe në banesat shtetërore a private, në raste flagrante, për kapjen e autorëve të veprave penale që janë në ndjekje e sipër, si dhe për dhënien e ndihmës së nevojshme në raste fatkeqësish natyrore, aksidentesh dhe zjarri.

2. Të bllokojnë ose të rrethojnë pjesë të rrugëve, banesa, zyra e mjedise të tjera për nevoja të domosdoshme të kryerjes së detyrës.

3.Të shoqërojnë për në organet e ruajtjes së rendit personat që nuk pranojnë të paraqesin dokumente identifikimi, kundërshtojnë ose pengojnë forcat e ndërhyrjes së shpejtë gjatë kryerjes së detyrave, janë gjetur në vendin e ngjarjes dhe dyshohen se janë autorët e krimeve, mbajnë, përdorin dhe transportojnë lëndë eksplozive, narkotike e të tjera të kësaj natyre.

4.Të përdorin edhe armët e zjarrit për kryerjen e detyrave sipas kushteve të parashikuara nga dispozitat ligjore për përdorimin e armëve.

KREU V
PRANIMI, KUALIFIKIMI DHE SHËRBIMI I FORCAVE SPECIALE DHE ATYRE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 10

Kandidatët në forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë pranohen sipas kritereve të caktuara në ligjin nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit” dhe kritereve të tjera të veçanta për përgatitjen fizike speciale. Për këtë krijohet komisioni i posaçëm nga drejtoria e forcave speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë.

Kriteret e veçanta për përgatitjen fizike speciale dhe komisioni i posaçëm caktohen nga ministri.

Neni 11

Trajtimi i forcave speciale dhe atyre të ndërhyrjes së shpejtë, për natyrën e veçantë të shërbimit, bëhet me vendim te Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Ndalohet përdorimi i eksitanteve në forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë.

Neni 13

Ministria e Brendshme merr në mbrojtje punonjësit e forcave speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë, familjet e tyre si dhe pasurinë në rast kërcënimi për shkak të detyrës.

Neni 14

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme të nxjerrin aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 15

Ligji nr.7551, datë 22.1.1992 “Për forcat e ndërhyrjes së shpejtë” dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2004, datë 27.2. 1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani